



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_ . \_\_\_\_\_ . 2023

Lënda: Kthim përgjigje

Duke shprehur konsideratën për veprimtarinë e organizatës në të cilën ushtroni profesionin, në përgjigje të kërkesës tuaj regjistruar me numër rendor 37, në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve si dhe me aktin nr. 6336 Prot., datë 11.12.2023, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, si dhe në bazë të të dhënave që disponon Drejtoria e Burimeve Njerëzore, dosja personale e gjyqtarëve, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Znj. {...} ka kryer studimet e larta pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës në vitet akademike 2002-2006.

Në vitet 2006-2007 ka kryer ciklin e dytë të studimeve në programin “Master në Shkenca Juridike në të Drejtë Ndërkombëtare Biznesi” pranë Universitetit të Europës Qendrore, Budapest, Hungari dhe në vitin 2011 ka përfunduar Doktoraturën në Shkenca Juridike, Universiteti i Europës Qendrore, Budapest, Hungari profili “E Drejtë Ndërkombëtare Tregtare”.

Në vitet 2018-2020 ka kryer studimet në Shkollën e Magjistraturës, Tiranë, duke fituar titullin “Magjistrat”, në profilin “Gjyqtar”, me vlerësimin Shumë Mirë.

Me anë të vendimit nr. 475, datë 20.10.2020, të Këshillit të Lartë të Gjyqësor, znj. {...} është emëruar gjyqtare.

Këshilli i Lartë i Gjyqësor, me vendimin nr. 516, datë 27.10.2020, ka vendosur që gjyqtarja e emëruar znj. {...} të caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}.

Në datën 12.07.2021, Këshilli i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}, ka vendosur të komandojë gjyqtaren znj. {...} si Zëvendës-Kryetare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}, detyrë të cilën e ka mbajtur deri në datën 06.09.2022 dhe në vijim ka ushtruar funksionin si gjyqtare pranë kësaj gjykate.

Me vendim nr. 137, datë 28.03.2023 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatës së Shkallës së Parë me Juridiksion të Përgjithshëm Tiranë”, nga data 01.05.2023 gjyqtarja znj. {...} është transferuar në pozicionin e përhershëm si gjyqtare pranë kësaj gjykate, ku dhe aktualisht ushtron detyrën.

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj gjyqësore, për gjyqtaren znj. {...} nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

Bashkëlidhur lutemi gjeni CV-në e znj. {...}, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksion të Përgjithshëm {...}.F